



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më 03.11.2025

MBLEDHJA Nr. 45,
Datë 06.11.2025, ora 10:00
e Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 06.11.2025, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 45 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 31.10.2025.
2. Mbi miratimin e metodologjisë për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë të ditës në avancë.
3. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.08.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “POWER ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 25 MW”.
4. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 31.07.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 30 MW”.
5. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 29.08.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë “ACHELO” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kotorri”.
6. Mbi njohjen e licencës për furnizimin me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, për subjektin “INTERENERGO D.O.O. – KOSOVA sh.p.k.”.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “BUSHTRICA 2017” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
8. Mbi kërkesën e shoqërisë “ELENERGJI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI